

BNJVL

METODOLOGJIA

për integrimin e perspektivës gjinore
në menaxhimin me mbetjet në nivel lokal

METODOLOGJIA

për integrimin e perspektivës gjinore në menaxhimin me mbetjet në nivel lokal

Autorë:

Irena Nikollov

Ivana Serafimova

Gordana Nestorovska

Mia Stalgren

Kjo Metodologji e përpiluar nga BNJLV, mbështetet nga projekti "Menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve në nivel lokal" i cili zbatohet nga Asociacioni Suedez i Autoriteteve Lokale dhe Rajoneve (SALAR International) me mbështetje financiare nga Suedia

PËRMBAJTJA

HYRJE 3

PJESA 1 Rëndësia e integrimit gjinor në shërbimet komunale për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal 4

1.1. Shërbimet komunale të menaxhimit me mbetje në nivel lokal 4

1.2. Integrimi gjinor në politikat dhe shërbimet publike 5

PJESA 2 Metodologjia për integrimin e perspektivës gjinore në shërbimet komunale për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal 10

2.1. Analiza e gjendjes aktuale të grave dhe burrave në sektorin e shërbimeve komunale 10

2.2. Planifikimi dhe miratimi i politikave dhe vendimeve lokale që përfshijnë perspektivën gjinore në dokumentet e ndërmarrjeve publike komunale dhe në programet e komunave 12

2.3. Buxhetim i përgjgjshëm gjinor i bazuar në nevojat e grave dhe burrave 14

2.4. Krijiimi i shërbimeve gjinore-të përgjegjshme komunale përmes ndërtimit të kapaciteteve në komunë dhe NPK për implementimin e metodologjisë për barazi gjinore 16

2.5. Ndjekja e implementimit dhe evalvimit të rezultatveve të pritura 17

PJESA 3 Mjetet për integrimin gjinor 20

HYRJE

Metodologjia për integrimin e perspektivës gjinore në menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal është hartuar në kuadër të projektit "Menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve në nivel lokal", i cili po zbatohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2023 - 2027 nga Asociacioni Suedez i Autoriteteve dhe Lokale dhe Rajoneve (SALAR International) dhe me mbështetje financiare të Suedisë.

Qëllimi kryesor i projektit është përmirësimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në Maqedoninë e Veriut përmes harmonizimit të plotë me standardet e BE-së, duke përmirësuar kështu qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor dhe cilësinë e jetës për të gjithë banorët.

Projekti zbatohet në komunat e rajoneve të Pellagonisë dhe Jugperëndimit dhe është në përputhje me Strategjinë suedeze të zhvillimit, agjendën për aderim në BE dhe strategjinë e përtrirë të decentralizimit të Maqedonisë së Veriut, si dhe progresin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

Një nga qëllimet specifike të projektit është mbështetja e komunave të përzgjedhura në integrimin e perspektivës gjinore përmes zhvillimit të metodologjive dhe instrumenteve për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për menaxhimin e mbetjeve në proceset e planifikimit të menaxhimit të mbetjeve dhe ofrimin e shërbimeve.

Çelësi i barazisë gjinore është identifikimi, njohja dhe adresimi i pabarazive gjinore me masa adekuate: aktivitete sensitive ndaj gjinisë dhe aksioneve afirmative në dobi të palës në pozitë më pak të lakmueshme.

Për të mbështetur komunat në integrimin e një perspektive gjinore në menaxhimin e mbetjeve në të gjitha fazat e krijimit të politikave dhe buxhetit, BNJLV në bashkëpunim me SALAR International ka përgatitur këtë Metodologji për integrimin e perspektivë gjinore në shërbimet e menaxhimit të mbetjeve komunale në nivel lokal, e cila është e lidhur me Metodologjinë e BNJLV-së për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe buxhetet lokale. Kjo Metodologji duhet të përfaqësojë një udhërrëfyes me hapa dhe mjete konkrete për komunën (kryetarin e komunës, administratën komunale, Këshillin), por edhe për udhëheëqsinë dhe administratën e Ndërmarrjeve Publike Komunale (NPK) në komuna, duke marrë parasysh se mund të përdoret edhe për shërbime të tjera komunale në nivel lokal.

Kjo Metodologji mbindërtohet në vlerësimin gjithëpërfshirës paraprak të kapaciteteve komunale për integrimin gjinor në ofrimin e shërbimeve, veçanërisht në menaxhimin e mbetjeve, dhe synon të kapërcejë sfidat dhe mangësitë e identifikuara të komunave dhe ndërmarrjeve komunale në ofrimin e shërbimeve të barabarta grave dhe burrave në nivel lokal.

Zhvillimi i kësaj Metodologjie është në përputhje me Kartën evropiane për barazi gjinore të Këshillit Evropian të Komunave dhe Rajoneve - CEMR, të nënshkruar nga 23 komuna në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me "Metodologjinë për integrimin e perspektivës gjinore në politikat lokale dhe buxhetet të BNJLV-së", "Metoda 4R" të Asociacionit Suedez të Autoriteteve Lokale dhe Rajoneve – SALAR, si dhe me Metodologjinë e NALAS-it "Si të përfshihet perspektiva gjinore në menaxhimin e mbetjeve".

Kjo metodologji është e ndarë në 3 pjesë. Pjesa e parë përmban një pasqyrë të përgjithshme të domethënies së integrimit të perspektivës gjinore në shërbimet e menaxhimit të mbetjeve komunale në nivel lokal, duke siguruar kehje të përgjithshme dhe përkufizime të termave. Pjesa e dytë përmban një metodologji të detajuar për integrimin e perspektivës gjinore në menaxhimin e mbetjeve, ndërsa pjesa e tretë përbëhet nga një sërë instrumentesh që personeli i komunës dhe NPK mund të përdorin për të adresuar nevojat gjinore në ofrimin e shërbimeve lokale.

PJESA 1

Rëndësia e integrimit gjinor në shërbimet komunale për menaxhim të mbetjeve në nivel lokal

Komunat janë pika e parë e kontaktit për banorët në realizimin e të drejtave dhe nevojave të tyre në pothuajse të gjitha domenet e jetës shoqërore. Në realizimin e nevojave të tyre dhe zgjidhjen e problemeve, komunat ofrojnë shumë shërbime në nivel lokal, përfshirë këtu shërbimet komunale. Kompetencë e komunave është ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale, ndriçimi publik, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, si dhe menaxhimi i mbetjeve (mbledhja dhe deponimi). Këto shërbime janë me rëndësi të madhe për të gjithë banorët, gra dhe burra, vajza dhe djem.

1.1. Shërbimet komunale për menxhimin e mebtjeve komunale në nivel lokal

Menaxhimi i mbetjeve sipas Ligjit për menaxhimin e mbetjeve përfshin të gjitha aktivitetet nga gjenerimi deri te mbledhja, ruajtja dhe deponimi i mbetjeve ose një përmbledhje aktivitetesh, masash dhe vendimesh që synojnë shmangien dhe zvogëlimin e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe ndikimin e saj negativ në mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njeriut, përfshirë këtu edhevtrajtimin e mbetjeve.

Në këtë kontekst, menaxhimi i mbetjeve shpesh perceptohet si një çështje teknike ose teknologjike dhe për këtë arsye është plotësisht i zhveshur nga perspektiva gjinore. Megjithatë, një kuptim i tillë nuk është plotësisht i saktë sepse në shumë mënyra sistemet e menaxhimit të mbetjeve përcaktohen dhe varen nga sjellja dhe kërkesat e njerëzve që mund të ndryshojnë dhe shpesh ndryshojnë midis burrave dhe grave. Sipas disa hulumtimeve, është konstatuar se ka dallime në mënyrën se si gratë dhe burrat i shohin mbeturinat, si dhe se riciklimi dhe ripërdorimi i mbeturinave kanë dimensione të caktuara gjinore. Për më tepër, duhet të merren në konsideratë një numër i madh aspektesh të menaxhimit të mbetjeve që ndikojnë ndryshe në grupe të ndryshme shoqërore, duke përfshirë burrat dhe gratë, në raport me nevojat dhe aftësitë e tyre.

Menaxhimi i mbeturinave gjithashtu mund të ketë ndikime të dyfishta ekonomike dhe financiare në komunitetet lokale dhe shoqërinë në përgjithësi. Në shoqëritë më të varfra dhe më pak të zhvilluara, angazhimi në sistemin e menaxhimit të mbetjeve është shpesh një mundësi për gratë për të gjeneruar të ardhura shtesë për amvisëritë dhe familjet e tyre. Nga ana tjetër, hulumtimi i paradokohshëm tregon një korrelacion të qartë pozitiv midis shkallës së punësimit të grave dhe përfaqësimit të tyre në strukturat ekzekutive të kompanive, gjë që më pas kontribuon në rritjen e performancës financiare, efikasitetit, kreativitetit dhe inovacionit[1].

Si përfundim, menaxhimi i mbeturinave, sipas ligjit, por edhe në jetën e përditshme të qytetarëve, kuptohet si një shërbim me interes të veçantë për publikun dhe për këtë arsye duhet të trajtohet si i tillë për sa i përket fushëveprimit, cilësisë, efektivitetit dhe efikasitetit të shërbimit. Si një shërbim me interes publik, menaxhimi i mbeturinave duhet të përmbushë gjithashtu nevojat e grupeve të ndryshme shoqërore, duke përfshirë gratë dhe burrat, të cilët mund të kenë pikëpamje dhe kërkesa krejtësisht të ndryshme në lidhje me këtë shërbim.

[1] Global Gender Gap Report 2024 | World Economic Forum; 3.7 million women held managerial positions in 2023 - News articles - Eurostat; How diversity, equity, and inclusion (DE&I) matter | McKinsey; Why Gender Equity in the Workplace is Good for Business - Professional & Executive Development | Harvard DCE

1.2. Integrimi gjinor në politikat publike dhe shërbimet

Komunat, sipas vendosjes të tyre në sistem, janë të pozicionuara në mënyrë unike si aktorë kyç në procesin e qeverisjes së drejtë, gjithëpërfshirëse, efikase dhe transparente, dhe është shumë e rëndësishme që një komunë e përgjegjshme ndaj gjinisë të parashikojë plotësisht dimensionin gjinor në politikat, buxhetin dhe praktikat e saj të qeverisjes. Komunat janë zgjedhja e parë dhe më e afërt e qytetarëve në realizimin e të drejtave dhe nevojave të tyre, dhe për këtë arsye obligimet dhe kompetencat e komunave për t'i ditur dhe njohur nevojat dhe kontekstin e komunitetit dhe rrjedhimisht për të adresuar pabarazitë gjinore përmes ofrimit të shërbimeve lokale të përgjegjshme gjinore. Në çdo shtet (me zhvillim të lartë ose në zhvillim) shoqëri, grup, institucion ose familje ekziston një i ashtuquajtur sistem gjinor. Sistemi gjinor është një kornizë që i vendos burrat dhe gratë në relacione specifike, kështu që karakteristikat e grupit të tyre, por edhe jeta e tyre personale, mund të kuptohen përmes këtij shablloni.

Të kuptuarit e sistemit gjinor është një parakusht i domosdoshëm për adresimin e pabarazisë, krijimin e politikave të ndjeshme gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore. Për ta kuptuar këtë, është e nevojshme të bëhet dallimi midis seksit, i cili lidhet me karakteristikat biologjike dhe psikologjike të një personi të fituara nga lindja, ndërsa gjinia është një koncept sociologjik që krijon rolet, sjelljet, pozicionet dhe aktivitetet e personit që shoqëria ua cakton grave dhe burrave dhe vajzave dhe djemve, gjë që çon në pabarazi gjinore.

Çështjet gjinore mbulojnë çdo aspekt të jetës së një gruaje ose burri, që përfshin nevojat dhe sfidat specifike që lidhen me moshën, përkatësinë etnike dhe kulturore, si dhe statusin socioekonomik, dhe kërkojnë një qasje të ndryshme për zgjidhjen e tyre. Komunat duhet t'i marrin parasysh të gjitha këto aspekte kur krijojnë politikat dhe buxhetet e tyre në mënyrë që të përmbushin nevojat e grupeve të ndryshme në komunitet.

Integrimi gjinor[2] pranohet ndërkombëtarisht si një strategji për arritjen e barazisë gjinore. Ai përfshin integrimin e një perspektive gjinore në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, masave rregullatore dhe programeve të shpenzimeve, me qëllim promovimin e barazisë midis grave dhe burrave dhe luftimin e diskriminimit. Integrimi gjinor, ose përfshirja e një perspektive gjinore në integrimin, politikat dhe praktikat, nënkupton (ri)organizimin, përmirësimin, zhvillimin dhe vlerësimin e politikave, strategjive, programeve dhe praktikave të përgjithshme, në mënyrë që një perspektivë gjinore të përfshihet në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat nga aktorët e përfshirë në krijimin e politikave për të arritur barazi de facto. Integrimi gjinor nuk do të thotë shtimi i një komponenti femëror, por kjo do të thotë **përvoja, njohuritë dhe interesat e grave dhe burrave të vendosen në agjendën zhvillimore.**

[2] https://eige.europa.eu/

Dimensionet e integrimit gjinor janë:

- ✓ Përfaqësim i barabartë i grave dhe burrave në procesin e krijimit të politikave, impementimit, por edhe si përfitues të politikave të zbatuara
- ✓ Perspektiva gjinore në përmbajtjen e politikave

Për të përcaktuar se në çfarë mase përfshihet perspektiva gjinore në programet, pyetjet kryesore që duhet të bëjmë janë si më poshtë:

- A njihen dhe merren në konsideratë nevojat e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në lidhje me shërbimet komunale (menaxhimin e mbeturinave)? A ka dispozita që kërkojnë procese konsultative me pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave dhe grupeve të tjera të cenueshme?
- A janë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë të përfshirë në mënyrë të barabartë në vendimet që lidhen me shërbimet publike? A ka dispozita për pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave dhe grupeve të tjera të cenueshme në proceset pjesëmarrëse ose organet rregullatore?
- A kanë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë qasje të barabartë në burimet për shërbimet komunale (materiale-financiare, arsimore, etj.)? Kush merr pjesë në kontrollin dhe përfiton nga resurset e dedikuara për shërbimet komunale?
- A përfitojnë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë në mënyrë të barabartë nga dispozitat ligjore dhe politikat e tjera lokale (programet vjetore) që lidhen me shërbimet komunale? A monitorohen aktivitetet dhe a parashikohet një vlerësim i arritjeve, duke marrë parasysh nevojat dhe sfidat specifike të grave dhe burrave në lidhje me shërbimet komunale?

Një prej instrumenteve që pasqyron variacionin **në llojin e rezultateve gjinore të ndërhyrjeve ose politikave** me pesë kategori, është Korniza e efektivitetit të rezultateve gjinore (GRES)[3] e cila ofron udhëzime për zbatimin e analizës gjinore-të përgjegjshme të rezultateve të evalvimeve ose vlerësimeve në raste të ndryshme të përdorimit, duke theksuar se si të integrohet GRES në fazat e dizajnimit, implementimit dhe evalvimit të programeve. Qëllimi i GRES është t'u ofrojë udhëzime vlerësuesve për zbatimin e analizës gjinore-të përgjegjshme të rezultateve në evalvime apo vlerësime. Për rangimin e ndërhyrjeve dhe aktiviteteve për barazinë gjinore, është shfrytëzuar shkalla e mëposhtme: negative ndaj gjinisë, e verbër ndaj gjinisë, e ndjeshme ndaj gjinisë, e përgjigjshme ndaj gjinisë dhe transformuese ndaj gjinisë, varësisht nëse ndërhyrja/politika i merr parasysh pabarazitë gjinore.

[3] GRES_English.pdf (undp.org)

Korniza e efektivitetit të rezultateve gjinore (GRES)*



* Shkalla është përshtatur nga Evalvimi i kontributit të UNDP-së për barazinë gjinore dhe vlerësimin e fuqizimit të grave.

Integrimi gjinor përfshin **identifikimin e nevojës për ndryshim** në agjendën e të gjitha politikave, programeve, aktiviteteve dhe zbatohet nëpërmjet:


- Analizimit të situatës momentale midis grave dhe burrave
- Identifikimit të pabarazive midis grave dhe burrave
- Zhvillimit të politikave që synojnë të zvogëlojnë këto pabarazi.

Zbatohet në çdo fushë, në çdo nivel, në çdo politikë, program ose aktivitet projekti.

Konceptet e integrimit gjinor dhe interseksionalitetit janë të lidhura ngushtë, dhe të kuptuarit e lidhjes së tyre është kyç për një punë efektive të barazisë gjinore, duke pranuar se «gratë» dhe «burrat» nuk janë grupe homogjene. Për të adresuar në mënyrë efektive barazinë gjinore, praktikat e integrimit gjinor duhet të marrin në konsideratë lidhjen e gjinisë me faktorë të tjerë shoqërorë, siç janë raca, klasa dhe handikapi, të cilat krijojnë përvoja të ndryshme për gratë dhe burrat.[4]

[4] Ç'është interseksionaliteti? Dhe për se është i rëndësishëm për barazinë gjinore? | United Nations Development Programme

Procesi i integrimit gjinor ndjek procesin e krijimit të politikave në nivel lokal në cilëndo nga fazat e mëposhtme:



Instrumentet dhe metodat për integrim gjinor të cilat mund të përdoren për secilën fazë, janë:

Instrumente për identifikimin e nevojave	Instrumente për fazën e planifikimit	Instrumente për fazën e zbatimit	Instrumente për monitorimin dhe evalvimin e politikave
Statistikë gjinore	Vendosja e indikatorëve gjinorë	Zhvillimi i kapaciteteve për barazi gjinore	Revizion i aspekteve gjinore
Analizë gjinore	Planifikim sensitiv gjinor i ndërhyrjeve/ politikave	Transformim sensitiv gjinor i institucioneve	Monitorim sensitiv gjinor
Vlerësim gjinor	Buxhetim i përgjegjshëm gjinor	Ndërgjegjësim për çështje gjinore	Evalvim sensitiv gjinor
Konsultim me palët e prekura	Prokurime publike sensitive gjinore		

Një analizë e plotë gjinore u mundëson **politikëbërësve** të kuptojnë pabarazitë gjinore në një situatë ose sektor të caktuar, pasi jo vetëm që përshkruan situatën aktuale sipas gjinisë, por gjithashtu eksploron shkaqet dhe efektet e dallimeve gjinore në grupin e synuar.

Analiza gjinore[5] është një mjet për diagnostikimin e dallimeve midis grave dhe burrave në aspektin e aktiviteteve të tyre specifike, kushteve, nevojave, aksesit dhe kontrollit mbi resurset, si dhe aksesit të tyre në përfitimet zhvillimore dhe vendimmarrjen. Ajo shqyrton lidhjet midis këtyre dhe faktorëve të tjerë në kontekstin më të gjerë socio-kulturor, ekonomik, politik dhe mjedisor. Ekziston një ndryshim midis nevojave praktike dhe nevojave dhe interesave strategjike të grave dhe burrave. Të kuptuarit e këtij ndryshimi na ndihmon t'i identifikojmë masat pozitive që mund të merren për të korrigjuar pabarazitë midis grave dhe burrave.

Nevojat praktike janë ato që konsiderohen si domosdoshmëri urgjente si për gratë ashtu edhe për burrat (nevoja themelore si uji, ushqimi, të ardhurat, strehimi dhe kujdesi shëndetësor). Iniciativat që synojnë vetëm të përmbushin nevojat praktike përpiqen t'u përgjigjen çështjeve që rrjedhin nga kushtet e papërshtatshme të jetesës.

Interesat strategjike kanë të bëjnë me statusin relativ të grave dhe burrave në shoqërinë e tyre. Këto interesa ndryshojnë nga një kontekst në tjetrin dhe lidhen me ndryshimin e pozicionit ose statusit të grave përmes adresimit të roleve gjinore dhe pritjeve, si dhe ndarjen gjinore të punës, resurseve dhe pushtetit. Shembuj të iniciativave për promovimin e interesave strategjike përfshijnë mbrojtjen nga dhuna në familje, zvogëlimin e hendekut të pagave dhe rritjen e mundësive të grave për vendimmarrje.

Në përputhje me nevojat e identifikuara, komuna duhet të krijojë programe, politika dhe masa specifike gjinore, duke alokuar mjete të mjaftueshme financiare për zbatimin e tyre. Obligim i tyre është t'u ofrojnë qytetarëve shërbime cilësore dhe sensitive gjinore në të gjitha fushat ku kompetencat i ka komuna. Në praktikën e deritashme, shumica e shërbimeve të cilt i financojnë komuna të caktuara nga buxhetet vetanake, janë në fushat e mbrojtjes sociale dhe shërbimeve sociale, arsimit, shëndetësisë, ndërsa shërbimet komunale dhe urbane pothuajse nuk njihen si një fushë në të cilën duhet të integrohet perspektiva gjinore.

Metodologjia për integrimin e perspektivës gjinore në menaxhimin e mbetjeve mund t'i sigurojë përfitimet e mëposhtme për komunat dhe NPK-të:

- Të dhëna statistikore të ndara sipas gjinisë
- Pjesëmarrje e forcuar e qytetarëve dhe konsultime me palët e interesuara në procesin e planifikimit të shërbimeve komunale
- Krijimi i shërbimeve komunale të përshtatura për të gjitha kategoritë e qytetarëve, me fokus në grupet vulnerabël dhe perspektivë e integruar gjinore
- Promovimi i Planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbetjeve me perspektivë gjinore
- Vetëqeverisje lokale dhe NPK sensitive gjinore në të gjitha nivelet organizative
- Ofrimi i shërbimeve të përmirësuara, cilësore dhe efikase sensitive gjinore
- Konsultim dhe komunikim me banorët dhe informacione mbi përparësitë e menaxhimit të mbetjeve (selektimi, kompostimi, riciklimi) përmes fushatave të ndryshme ndërgjegjësuese
- Shërbime lokale më të mira si për gratë ashtu edhe për burrat
- Metodologji e unifikuar për futjen e një perspektive gjinore në shërbimet komunale në nivel lokal

[5] ABC of Women Worker's Rights and Gender Equality, International Labour Organization (2007)

PJESA 2

Metodologjia për integrimin e perspektivës gjinore në shërbimet komunale për mexhaimin e mbetjeve në nivel lokal

Metodologjia përmban hapa për përfshirjen e perspektivës gjinore në procesin e zhvillimit të politikave dhe zbatimin e tyre në menaxhimin e mbetjeve me rekomandime specifike të udhëhequra nga legjislacioni kombëtar, dokumentet ndërkombëtare dhe praktikat nga vendet e BE-së.

Kjo pjesë ofron një përshkrim të aspekteve/pjesëve të ndryshme të metodologjisë. Duke pasur parasysh që metodologjia ilustrohet përmes menaxhimit të mbeturinave, shumica e rekomandimeve janë të orientuara posaçërisht në këtë kompetencë komunale. Megjithatë, të gjitha pjesët e metodologjisë mund të zbatohen në shërbime të tjera komunale.

Pikat kryesore të hyrjes për integrimin gjinor në shërbimet e menaxhimit të mbeturinave komunale janë:

1) Analiza e situatës aktuale të grave dhe burrave në sektorin e shërbimeve komunale bazuar në sistemin për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë

2) Planifikimi dhe miratimi i politikave dhe vendimeve lokale që përfshijnë një analizë të nevojave të ndryshme të grave dhe burrave

3) Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor bazuar në nevojat e grave dhe burrave

4) Zbatimi i një metodologjie për shërbimet komunale të përgjigjshme ndaj gjinisë

5) Monitorimi dhe evalvimi i rezultateve të pritura

2.1. Analiza e gjendjes aktuale të grave dhe burrave në sektorin e shërbimeve komunale

Analiza është fazë përgatitore në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të Planeve të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe ky është një proces shumë i rëndësishëm dhe kompleks, i cili duhet të japë pamjen e gjerë të gjendjes së grave dhe burrave në menaxhimin e mbeturinave në komunë. *Në fakt, kjo është hartëzim gjinor që përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave sipas kornizës që zakonisht ofrohet nga ligji për menaxhimin e mbeturinave.* Është e nevojshme të identifikohen burimet e informacionit, qofshin ato statistika zyrtare shtetërore, të dhëna të disponueshme nga kompanitë lokale të shërbimeve apo informacione të tjera të cilat i posedojnë institucionet ose organizatat përkatëse.

Statisika gjinore[6] është statistikë që pasqyron në mënyrë adekuate ndryshimet dhe pabarazitë e pozicionit të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës. Statistikat gjinore dallohen nga karakteristikat e mëposhtme: (a) të dhënat mblidhen dhe paraqiten të ndara sipas gjinisë si një klasifikim parësor dhe i përgjithshëm; (b) të dhënat pasqyrojnë problematikat - çështjet, problemet dhe shqetësimet gjinore

[6] https://eige.europa.eu/taxonomy/term/1294?language_content_entity=mk

që lidhen me të gjitha aspektet e jetës së grave dhe burrave, duke përfshirë nevojat e tyre specifike, mundësitë dhe kontributet në shoqëri; (c) të dhënat bazohen në koncepte dhe përkufizime që pasqyrojnë në mënyrë adekuate diversitetin e grave dhe burrave dhe kapin të gjitha aspektet e jetës së tyre; dhe (d) metodat e mbledhjes së të dhënave, marrin parasysh stereotipet dhe faktorët socialë dhe kulturorë që mund të nxisin paragjykimet gjinore.

Megjithatë, analiza themelore nuk duhet të kufizohet vetëm në të dhënat teknike, por, në përputhje me praktikat më të mira evropiane, duhet të përfshijë të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi mendimet e qytetarëve/klientëve mbi cilësinë e shërbimit, problemet që ata identifikojnë dhe nevojat e tyre. Një model pyetësori për ***përcaktimin e kënaqësisë së përdoruesve me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve është dhënë në ANEKSIN 1***. Gjatë zbatimit të pyetësorit, ai duhet të shpërndahet gjerësisht dhe të gjithë qytetarët duhet të inkurajohen të përgjigjen, pavarësisht nëse janë kryefamiljarë apo anëtarë të familjes. Gjatë analizimit të të dhënave, duhet t'i kushtohet vëmendje ndryshimeve të identifikuara në kënaqësinë midis grave dhe burrave.

Ligji aktual për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (Neni 18) përcakton që njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe organet e njësive të vetëqeverisjes lokale janë të obliguara ligjërisht të mbledhin, regjistrojnë dhe përpunojnë të dhëna statistikore, dhe gjithashtu kërkon që ato t'i paraqesin këto të dhëna sipas gjinisë dhe t'ia dorëzojnë ato Entit Shtetëror të Statistikave.

Ndërmarrjet publike komunale mund t'i mbledhin dhe analizojnë të dhënat e mëposhtme për të përmirësuar dhe integruar komponentin gjinor në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal:

- ✓ Analiza e punonjësve sipas gjinisë, moshës, arsimit me qëllim identifikimin e hendeqeve gjinore në strukturën e ndlrmarrjes.
- ✓ Mund të bëhen analiza plotësuese të kërkesave për pushim mjekësor të grave dhe burrave dhe për të vlerësuar nëse ka ndonjë trend në sëmundjet profesionale që mund të parandalohet në kohën e duhur, duke marrë parasysh llojin e punës dhe kontaktin me mbeturinat me origjinë të ndryshme.
- ✓ Analiza e shfrytëzuesve femra dhe meshkuj dhe rregullsia e pagesës së faturave. Kjo mund të shërbejë për fushata për të përmirësuar pagesat ndër shfrytëzuesit dhe për të zvogëluar barrën mbi familjet në arkëtimet e detyrueshme për shkak të faturave të vonuara.
- ✓ Evidentimi dhe analiza e kërkesave, ankesave dhe parashtresave të tjera nga gratë dhe burrat. Ky informacion mund të shërbejë për të monitoruar efektivitetin dhe efikasitetin e punës së ndlrmarrjes, por edhe si informacion hyrës për përgatitjen e programeve vjetore për vitin e ardhshëm.

Të njëjtat të dhëna duhet të analizohen në nivel komunal, me qëllim përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Tabela Excel për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë në Ndërmarrjet Publike Komunale dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, është paraqitur në Aneksin 2 të këtij dokumenti.

Njësitë e vetëqevisjes lokale dhe Ndërmarrjet publike komunale gjithashtu mund të analizojnë të dhëna relevante nga burime të tjera me qëllim përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të dhënat e ndara sipas gjinisë mblidhen në disa platforma si Indeksi gjinor, i cili është një tregues kompozit që përmbledh situatën në 3 fusha për secilën komunë. Për llogaritjen e fundit të indeksit (viti 2021), u kërkuan të dhëna nga 9 institucione publike dhe 81 njësi të vetëqeverisjes lokale[7].

[7] https://rodovindeks.mk/metodology

Platforma e Statistikave Gjinore https://rodovistatistiki.stat.gov.mk/ është e lidhur drejtpërdrejt me bazën e të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, MakStat, dhe është një mjet për shqyrtim interaktiv të treguesve statistikorë të ndjeshëm ndaj gjinisë që paraqiten në një mënyrë grafike që është më e lehtë për t'u kuptuar. Baza e të dhënave MakStat e ESHS-së përmban një pjesë të veçantë për statistikat gjinore dhe ka të dhëna të ndara sipas gjinisë në disa fusha të mbledhjes dhe prezantimit të të dhënave. Disa nga statistikat më të rëndësishme janë përzgjedhur për prezantim në platformë dhe menaxhohen dhe përditësohen nga Enti Shtetëror i Statistikave të Maqedonisë së Veriut.

Platforma e BNJLV-së për barazi gjjinore dhe buxhetim të përgjegjshëm gjinor www.rob.zels.org.mk shërben si një qendër informacioni mbi aktivitetet dhe sukseset e komunave në këtë fushë, duke paraqitur praktikat e tyre më të mira, por edhe si një mjet për prezantimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë sipas zonave dhe komunave.

2.2. Planifikimi dhe miratimi i politikave dhe vendimeve lokale që përfshijnë perspektivën gjinore në dokumentet e ndërmarrjeve publike komunale dhe në programet e komunave

Ky aspekt përfshin ndarjen e informacioneve, krijimin e strukturave dhe mekanizmave të punës, përfshirjen e palëve të interesuara, krijimin e komunikimit të brendshëm dhe zhvillimin e një plani për komunikim të jashtëm. Hulumtimi i kryer në kuadër të projektit tregoi se dokumentet organizative nuk janë në përputhje me dispozitat e Ligjit për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, dhe se në thelb të gjitha dokumentet përmbajnë politika/intervenime të verbëra ndaj gjinisë që nuk bëjnë dallim midis burrave dhe grave, respektivisht hendeqet ekzistuese në nevojat dhe sfidat e grave dhe burrave në sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të mbeturinave. Qëllimi është të demonstrohen dhe zbatohen politika, masa dhe aktivitete përmes dokumenteve sensitive gjinore dhe çojnë në politika transformuese gjinore që synojnë burrat ose gratë (ose të dy gjinitë) dhe e detektojnë ekzistencën e nevojave dhe kufizimeve specifike gjinore. Këto politika synojnë të transformojnë shpërndarjen ekzistuese të pushtetit, resurseve dhe përgjegjësive në mënyrë që të krijojnë marrëdhënie të barabarta midis burrave dhe grave. Objektiv i ndërhyrjes mund të jenë burrat dhe gratë ose vetëm një grup. Politikat transformuese gjinore përqendrohen kryesisht në interesat strategjike gjinore, por gjithashtu mund të adresojnë nevojat praktike gjinore në një mënyrë që ka potencial transformues (mundëson një mjedis të favorshëm për (vetë)fuqizimin e grave).

Sa i përket ndërmarrjeve publike komunale, kjo mund të arrihet, për shembull, nëpërmjet masave të mëposhtme:

1. **NKP-të mund të ndërmarrin aktivitetet e mëposhtme në lidhje me përgatitjen e politikave dhe vendimeve të tyre që përfshijnë perspektivë gjinore:**

- Hapi i parë që NPK-të duhet ta ndërmarrin është të kryejnë një analizë gjinore të strukturës, pra të punonjësve në ndërmarrjen sipas gjinisë, moshës dhe arsimit. Kjo do të tregojë hendeqet e para gjinore në strukturën e NPK-së.

- Hapi i dytë është të përfshihet një perspektivë gjinore në Statut si një dokument politikash i ndërmarrjes që përcakton se si do të vendosen gjërat brenda vetë ndërmarrjes, kush ka pushtet dhe si do të merren vendimet, dhe në përgjithësi udhëzimet e përgjithshme për punën. Sipas analizës, duhet të shtohen dispozita normative që do të mundësojnë:

  - ✓ Në komisionet dhe organet e ndryshme (Bordi drejtuea, Bordi për kontrollin e çështjeve materiale dhe financiare, Këshilli i të punësuarve, Kolegjiumi profesional, komisionet, etj.) t'i kushtohet vëmendje paritetit, respektivisht balancit midis grave dhe burrave.

- ✓ Me rastin e punësimit, duhet të ketë mundësi për të aplikuar masa afirmative që do të mundësojnë punësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar në pozicione pune ku deri më tani janë punësuar vetëm burra, ndërsa nuk ka kufizime për punësimin e grave. Sigurisht, për shkak të dallimeve biologjike, një nga gjinitë do të mbizotërojë në pozicione të caktuara, por duhet të parashikohen kushte edhe për gjininë më pak të përfaqësuar.

- ✓ Në aktet që i miraton ndërmarrja, duhet të shtohet një procedurë ose rregullore për raportimin e ngacmimit në vendin e punës[8]. (që përfshin edhe mbrojtjen nga ngacmimi seksual) në përputhje me Ligjin për mbrojtjen nga ngacmimi në vendin e punës, i cili do të krijojë një bazë sistemike për veprime parandaluese dhe procedimin e rasteve të ngacmimit në vendin e punës. Kjo është e rëndësishme nga perspektiva e grave, të cilat janë të punësuara në numër më të vogël, të dinë se ekziston një politikë që ndalon ngacmimin si nga/midis kolegëve, por edhe nga klientët dhe qytetarët kur punojnë në vend të hapur. Informimi i punonjësve, si grave ashtu edhe burrave, për politikat ekzistuese. (Shembull i procedurës mund të gjendet në Aneksin 3).

- ✓ Përcaktimi i një procedure për miratimin e programeve vjetore të NPK-ve që do të parashikojnë anketa të rregullta me shfrytëzuesit e shërbimeve dhe analiza të ndara sipas gjinisë, analizë të kërkesave dhe ankesave nga burrat dhe gratë shfrytëzues të shërbimeve.

- ✓ Potencimi i detyrimit për të mbledhur dhe shfaqur të dhëna të ndara sipas gjinisë, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për mundësi të barabarta[9].

- ➘ NPK mund të krijojë një kornizë programore duke përfshirë pyetje (udhëzime) mbi elementët që duhet të përmbajë një program i përgjegjshëm gjinor i NPK-së. Një shembull i një kornize elementësh për një program të përgjigjshëm ndaj gjinisë, të zhvilluar brenda kornizës së Programit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor të UNWOMEN, është dhënë në Aneksin 4.

- ➘ Implementimi i prokurimeve publike të përgjegjshme ndaj gjinisë (një shpjegim i konceptit është dhënë në Aneksin 5).

[8] Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.79/13 dhe 147/15 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriu" nr. 103/21, Ligji për mbrojtje nga ngacmimi në vendin e punës

[9] Neni 18 - Prezantimi i të dhënave statistikore: Kuvendi, Qeveria, organet e administratës shtetërore, organet e jurispudencës dhe organet e tjera shtetërore, organet e njësisë së vetëqeverisjes lokale, personat juridikë të cilëve me ligj u është besuar kryerja e aktiviteteve me interes publik, shoqatat, fondacionet, ndërmarrjet publike, institucionet arsimore, institucionet në fushën e mbrojtjes sociale, institucionet shëndetësore, partitë politike, mediat, shoqëritë tregtare dhe subjektet e tjera që janë të ngarkuara me ligj të mbledhin, regjistrojnë dhe përpunojnë të dhëna statistikore, janë të detyruara t'i paraqesin këto të dhëna sipas gjinisë dhe t'ia dorëzojnë Entit Shtetëror të Statistikave.

Komunat mund të ndërmarrin aktivitetet e mëposhtme në lidhje me përgatitjen e politikave dhe shërbimeve të përgjigjshme gjinore:

- ✓ Vlerësimi i integrimit gjinor në nivel lokal duke përdorur listën e kontrollit të zhvilluar nga SALAR, e cila është dhënë në Aneksin 6.

- ✓ Vlerësimi i programeve aktuale të menaxhimit të mbetjeve komunale nga perspektiva gjinore duke përdorur pyetësorin e zhvilluar në kuadër të Programit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor të UNWOMEN, të dhënë në Aneksin 7. Ky instrument mund të ndihmojë administratën komunale të identifikojë pikat e mundshme për përmirësimin e integrimit të perspektivës gjinore në planet dhe buxhetet lokale.

- ✓ Sektori ose departamenti përgjegjës për përgatitjen e programit duhet të hartojë programe të përgjegjshme ndaj gjinisë bazuar në analiza dhe të dhëna. (Aneksi 3).

- ✓ Futja e një procedure që do të mundësojë pajtueshmërinë me Nenin 14, pika 3 e Ligjit për mundësi të barabarta, i cili parashikon: (3) Organet e njësive të vetëqeverisjes lokale, kur miratojnë plane zhvillimi dhe akte e vendime të tjera, janë të obliguara të shqyrtojnë dhe të marrin parasysh masat dhe aktivitetet e propozuara nga Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe nga Koordinatori për mundësi të barabarta të grave dhe burrave.

- ✓ Implementimi i prokurimeve publike të përgjegjshëm ndaj gjinisë (një shpjegim i konceptit është dhënë në Aneksin 5).

2.3. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor i bazuar në nevojat e grave dhe burrave

Buxhetimi me përgjegjshmëri gjinore synon analizimin e efekteve të ndryshme të shpenzimeve lokale, si dhe të politikave të të hyrave ndaj grave dhe vajzave, por edhe ndaj burrave dhe djemve, përkatësisht. Përveç analizës së ndikimit, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor përfshin propozime për përcaktimin e prioriteteve të ndryshme për shpenzimet dhe të ardhurat, duke marrë parasysh nevojat dhe prioritetet e ndryshme të grave dhe burrave. Në varësi të kontekstit specifik të vendit, mund të merren në konsideratë edhe faktorë të tjerë të pabarazisë, siç janë mosha, përkatësia fetare ose etnike, ose vendi i banimit (urban/rural, vendbanime të ndryshme). Këto buxhete[10] nuk janë specifike për gratë, por përfaqësojnë buxhete qeveritare që planifikohen, miratohen, ekzekutohen, monitorohen dhe rishikohen në mënyrë të ndjeshme gjinore. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor është vetë procesi. Ai duhet të jetë transparent dhe participativ, me përfshirje të gjerë të të gjithë palëve të interesuara dhe veçanërisht grupeve që zakonisht janë të margjinalizuara.

Tradicionalisht, gratë kanë qenë më pak aktive në procese të tilla në nivel lokal. Administrata lokale duhet të bëjë përpjekje shtesë për të mbështetur gratë dhe grupet e margjinalizuara në aspektin e kontributit të tyre përmes komenteve mbi objektivat prioritare të buxhetit dhe në revidimin pasues të shpenzimeve. Parakushti më i rëndësishëm për buxhetimin gjinor është vullneti politik i politikëbërësve për të punuar drejt barazisë gjinore dhe për të institucionalizuar procesin duke përmirësuar kornizën ligjore për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, duke forcuar mekanizmat institucionalë dhe duke ndërtuar kapacitetin e nevojshëm për të përfshirë një perspektivë gjinore në krijimin e politikave, programeve dhe buxheteve për to.

[10] Këto buxhete shpesh janë sinonim për buxhetet sensitive gjinore, buxhetet gjinore dhe buxhetet femërore

Ekzistojnë dy qasje kryesore për integrimin gjinor në procesin e buxhetit: qarkoret ose udhëzimet buxhetore të përgjegjshme ndaj gjinisë; paraqitja e raporteve buxhetore të ndjeshme ndaj gjinisë.

1. **Qarkore buxhetore ose udhëzime buxhetore të përgjegjshme ndaj gjinisë**

   Qarkulloret ose udhëzimet buxhetore të përgjegjshme ndaj gjinisë përmbajnë udhëzime të përgjegjshme ndaj gjinisë për institucionet shtetërore rreth hartimit të buxhetit. Në fillim të përgatitjes së buxhetit, ministritë ose departamentet e financave zakonisht janë përgjegjëse për lëshimin e udhëzimeve për përgatitjen e buxhetit. Kjo shpesh bëhet në formën e një qarkoreje buxhetore me udhëzime buxhetore. Një qarkore buxhetore është një njoftim zyrtar i lëshuar nga Ministria e Financave në fillim të procesit të hartimit të buxhetit· Ajo përmban udhëzime për ministritë dhe agjencitë e tjera qeveritare se si duhet të paraqesin kërkesat e tyre buxhetore për periudhën e ardhshme buxhetore. Shpesh përmban një format shumë konkfret të parashtresës së buxhetit· Një qarkore e tillë zakonisht e verbër në aspektin gjinor, por, prapëseprapë, ëahtë një pikënisje e mirë për përfshirjen e udhëzimeve specifike gjinore për ministritë e dikasterit.

2. **Llogaritë dhe raportet buxhetore të ndërgjegjshme ndaj gjinisë**

   Raportet buxhetore të ndërgjegjshme ndaj gjinisë synojnë të paraqesin implikimet e pritura të buxheteve në adresimin e çështjeve të pabarazisë gjinore. Ato janë një llogari ose raport nga Qeveria mbi mënyrën se si adresohen çështjet gjinore në politikat, shpenzimet dhe të ardhurat buxhetore. Një raport buxhetor i ndërgjegjshëm ndaj gjinisë është një dokument llogaridhënieje i përgatitur nga Qeveria që tregon se çfarë po bën Qeveria në aspektin e barazisë gjinore.

   Raport buxhetor i ndërgjegjshëm ndaj gjinisë ilustron qëllimin e Ministrisë/Komunës për të bërë diçka në lidhje me barazinë gjinore, dhe gjithashtu tregon se Ministria po ndan fonde buxhetore për angazhime politike· Idealisht, të gjitha ministritë do të përdornin formate standarde për raportet buxhetore të ndërgjegjshme ndaj gjinisë. Në këtë mënyrë, analiza e buxhetit gjinor e kryer nga Ministria/Komuna do të lidhej me objektivat e deklaruara dhe aktivitetet për t'i arritur ato.

   Ekzistojnë dy çështje që mund të ndihmojnë në zgjedhjen e aktiviteteve në të cilat duhet të përqendrohet një raport buxhetor gjinor në një sektor të caktuar:

   - Ku shkon pjesa më e madhe e parave?

   Kjo pyetje është e rëndësishme, sepse qasja e BPGJ është drejt integrimit të aspekteve gjinore, d.m.th. duke marrë parasysh çështjet gjinore në politikat kryesore dhe shpenzimet publike.

   - Cilat programe janë më të rëndësishme për barazinë gjinore?

   Kjo çështje është e dobishme, sepse ndonjëherë ekziston një aktivitet që kushton relativisht pak, por mund të bëjë një ndryshim të madh për barazinë gjinore.

Raportet e buxhetore të ndërgjegjshme ndaj gjinisë janë një mjet që duhet të përdoret brenda vetë vetëqeverisjes lokale.

2.4. Krijimi i shërbimeve komunale gjinore-të përgjegjshme përmes ndërtimit të kapaciteteve të komunës dhe NPK-së për implementimin e metodologjisë për barazi gjinore

Ndërtimi i kapaciteteve të të punësuarve edhe në komunë edhe në NPK

Kapaciteti përkufizohet si aftësi e individëve dhe organizatave për të ushtruar funksionet në mënyrë efikase, efektive dhe të qëndrueshme. Për të sqaruar kapacitetin në kontekstin e dhënë, është e nevojshme t'i përgjigjemi pyetjes: kapacitet për çfarë? Këtu kuptimi i kapacitetit ngushtohet si aftësia për të zgjidhur një problem, për të arritur ose ruajtur një mision dhe për të arritur qëllimet e vendosura. Ndërtimi i kapaciteteve është një koncept më i gjerë se zhvillimi organizativ, pasi përfshin sistemin, mjedisin jetësor ose kontekstin e përgjithshëm në të cilin individët, organizatat dhe shoqëria në tërësi punojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i kapaciteteve është një proces i vazhdueshëm dhe reciprok i përshtatjes së qëndrimeve, vlerave dhe praktikave organizative të njerëzve, ndërkohë që ndërton njohuri dhe aftësi të përshtatshme midis palëve të ndryshme të interesuara në një partneritet, domethënë, forcon aftësinë e secilit partner për të marrë vendime efektive për jetën e tyre dhe për të marrë përgjegjësi të plotë për pasojat e vendimeve të atilla.

Propozim tema për trajnim si për të punësuarit në NPK ashtu edhe në sektorët komunalë që lidhen me mjedisin jetësor dhe menaxhimin e mbetjeve:

- ✓ Çfarë do të thotë barazia gjinore?
- ✓ Çfarë do të thotë integrimi gjinor?
- ✓ Çfarë janë politikat lokale? Për kë hartohen politikat lokale dhe pse?
- ✓ Pse është e rëndësishme të përfshihet perspektiva gjinore në politikat lokale? Si mund të bëhet kjo? Shembuj
- ✓ Burimet e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe shfrytëzimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë
- ✓ Fushata (dhe anketa) të përgjegjshme ndaj gjinisë
- ✓ Si bëhet vlerësimi i politikave? Instrumentet për buxhetim të përgjegjshëm ndaj gjinisë
- ✓ Çfarë të dhënash duhet të përmbajë një program i përgjegjshëm ndaj gjinisë?
- ✓ Si monitorohet zbatimi i programeve? Si maten efektet?

Temat e propozuara mund të organizohen në pesë modulet e mëposhtme:

- ✓ **Moduli 1** *Termat dhe konceptet gjinore, sistemi gjinor dhe integrimi gjinor*
- ✓ **Moduli 2** *Menaxhimi i mbeturjeve*
- ✓ **Moduli 3** *Gjinia dhe menaxhimi i mbetjeve*
- ✓ **Moduli 4** *Integrimi gjinor në menaxhimin e mbetjeve*
- ✓ **Moduli 5** *Studimi i rastit*

2.5. Ndjekja e implementimit dhe evalvimi i rezultateve të pritura

Plani i veprimit për barazinë gjinore në shërbimet komunale për menaxhim të mbetjeve është dhënë në Aneksin 8.

Tabela për implementim të metodologjisë

Tabela më poshtë propozon hapat për impelentimin e metodologjisë. Çdo hap ka pjesën deskriptive, pjesën që specifikon rezultatin e pritur dhe sugjeron se kush duhet të jetë përgjegjës për hapin.

Hapi	Përshkrimi	Rezultatet	Personat përgjegjës
Sigurimi i mbështetjes politike	Mbështetja politike nga BNJVL-të dhe NPK-të duhet të jetë deklarative se angazhohen për të përfshirë perspektivën gjinore në shërbimet komunale	Deklaratë e personave udhëheqës	Sekretari i komunës/ udhëheqës i departamentit juridik në NPK
Formimi i ekipit sensitiv dhe lideri i tyre	Nominimi i personave nga komuna dhe NPK-ja. Propozohet të përfshihet në ekip një person përgjegjës nga departamenti komunal ose mjedisor, një koordinator për mundësi të barabarta dhe marrëdhënie me publikun	Ekip i krijuar	Sekretari i komunës/ udhëheqës i departamentit juridik në NPK
Zhvillimi i planit për futjen e Metodologjisë në nivel komunal	Definimi i qëllimeve dhe hapave për futjen e një perspektive gjinore në shërbimet komunale. Plani duhet të përfshijë indikatërë gjinorë për të matur progresin	Plan veprimi i hartuar	Lideri i ekipit sensitiv gjinor
Sigurimi i mbështetjes për palëte interesuara në nivel lokal dhe hartimi i planit për komunikim me publiun	Për informimin në kohë të publikut, është e nevojshme të zhvillohet një Plan për komunikim me publikun me fokus tek gratë në komunitetet lokale, respektivisht ashtu që informacioni të arrijë edhe tek ata	Plan për komunikim me publikun, i hartuar	PR-i dhe kordinatori për mundësi të barabarta
Grumbullimi dhe analiza e dokumenteve ekzistuese relevante	Mbledhja dhe analiza e dokumentacionit ekzistues, duke përfshirë Planin aksional për menaxhimin e mbeturinave, raportet nga komuna dhe NPK-ja, dokumentet strategjike, programet e punës për të identifikuar praktikat e mira dhe hendeqet gjinore në bashki	Rekomandime për masa potenciale për futjen e perspektivës gjinore në shërbimet komunale	Ekipi sensitiv gjinor/ Koordinatori për mundësi të barabarta dhe personi përgjegjës i departamentit të shërbimeve komunale/ mjedisit jetësor

Hapi	Përshkrimi	Rezultatet	Personat përgjegjës
Përgatitja e instrumenteve për aplikimin e Metodologjisë	Identifikimi dhe përshtatja e instrumenteve ekzistuese ose krijimi i instrumenteve të reja pas kryerjes së konsultimeve me palët e interesuara lokale	Instrument për hartëzimin e aktorëve lokalë, kahet për organizimin e fokus grupeve, pyetësor për matjen e kënaqësisë së shfrytëzuesve të fundit të shërbimebve komunale	Ekipi sensitiv gjinor/ Koordinatori për mundësi të barabarta dhe personi përgjegjës i departamentit të shërbimeve komunale/ mjedisit jetësor
Hartëzimi i aktorëve lokalë	Hartëzimi dhe analiza e aktorëve përkatës në komunitetin lokal, duke përfshirë administratën komunale, sektorin civil, mediat, bizneset lokale dhe grupe të tjera formale dhe joformale	Përmbledhje e pjesëmarrësve relevantë për zbatimin e pyetësorit dhe fokues grupeve	Ekipi sensitiv gjinor/ Koordinatori për mundësi të barabarta dhe PR-i
Zbatimi i Pyetësorit për matjen e kënaqësisë së qytetarëve	Huumtimi i kënaqësisë së shfrytëzuesve të shërbimeve komunale, por edhe zakonet dhe nevojat e tyre që duhet të japin një përgjigje për përmirësimin e shërbimeve komunale. Pyetësori është i ndjeshëm ndaj gjinisë dhe duhet të rezultojë nga gjetjet fillestare nga dokumentet ekzistuese në të cilat identifikohen hendeqet gjinore. Pyetësori duhet të ofrojë udhëzime për përcaktimin e rekomandimeve ose propozimeve për përmirësim me një perspektivë gjinore. Pyetësori duhet të identifikojë rolet dhe stereotipet gjinore nga të cilat duhet të dalin rekomandimet dhe masat për përmirësimin e shërbimeve komunale. Pyetësori duhet të mbulojë të gjitha kategoritë e shfrytëzuesve, veçanërisht personat vulnerabël dhe gratë në rrezik	Të identifikuara probleme konkrete, hendeqe gjinore dhe nevoja të shfrytëzuesve të shërbimeve komunale. Identifikimi i perspektivave dhe nevojave të ndryshme të grave dhe burrave	Ekipi sensitiv gjinor/ Koordinatori për mundësi të barabarta, koordinatori i PR-it dhe përfaqësuesi i ZHEL-it

Hapi	Përshkrimi	Rezultatet	Personat përgjegjës
Fokus grupet	Fokus grupet përbëhen nga gra dhe burra, gra dhe burra nga kategoritë vulnerabël, nga zona të ndryshme urbane, me qëllim identifikimin e nevojave të tyre të ndryshme dhe krijimin e zgjidhjeve të përshtatshme për t'i tejkaluar ato. Është e nevojshme të prioritizohen problemet dhe zgjidhjet në grupet e fokusit, si dhe të krijohen propozime që do t'i komunikohen udhëheqësisë së komunës dhe NPK-së	U identifikuan perspektiva dhe përvoja të ndryshme të grave dhe burrave në shfrytëzimin e shërbimeve komunale/ menaxhimin e mbetjeve. U identifikuan sugjerime dhe rekomandime që do të përpunohen në masat për tejkalimin e hendeqeve gjinore me një fokus të veçantë në grupet e cënueshme	Ekipi sensitiv gjinor/ Koordinatori për mundësi të barabarta, përfaqësues të departamentit të ZHEL-it dhe mjedisit jetësor
Vendosja e indikatërove gjinorë për monitorim	Krijimi i një "baseline" për situatën në komunë dhe identifikimi i fushës që ka nevojë për përmirësim me qëllim krijimin e ndërhyrjeve që do të maten përmes indikatorëve gjinorë	Plan monitorimi me indikatorë të përfshirë për matjen e progresit dhe indikatorë gjinorë	Ekipi sensitiv gjinor/ Koordinatori për mundësi të barabarta, përfaqësues nga departamentet e ZHEL-it dhe mjedisit jetësor
Definimi i masave dhe intervenimeve për shërbime komunale sensitive gjinore	Masat sensitive gjinore përfshihen në dokumentet/ planet e punës vjetore dhe strategjike lokale të komunës dhe të NPK-së	Plan i integruar për menaxhimin e mbetjeve me indikatorë gjinorë	Ekipi sensitiv gjinor/ Koordinatori për mundësi të barabarta, përfaqësues të departamentit të ZHEL-it dhe mjedisit jetësor
Monitorimi dhe evalvimi i rezultateve	Duke shfrytëzuar setin e indikatorëve, përfshirë këtu edhe indikatorët gjinorë dhe planin e monitorimit, NPK do të jetë në gjendje të monitorojë efektet e ndërhyrjeve dhe masave të prezantuara aty ku mblidhen të dhëna të ndara sipas gjinisë	Analizë gjinore me të dhëna të ndara gjinore	Ekipi sensitiv gjinor/ Koordinatori për mundësi të barabarta

Matrica e propozuar për ndjekjen e programeve lokale është dhënë në Aneksin 9.

PJESA 3

Mjetet për integrimin gjinor

Kjo pjesë e metodologjisë përmban rekomandime dhe instrumente që mund të përdoren në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë, mjetet e rekomanduara mund të përshtaten për t›u zbatuar në çdo shërbim tjetër komunal.

Seti i instrumenteve për integrimin gjinor përbëhet nga sa vijon:

Aneksi 1 - Pyetësor për përcaktimin e kënaqësisë së shfrytëzuesve nga shërbimi i menaxhimit të mbetjeve

Aneksi 2 - Tabela për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë

Aneksi 3 - Procedura për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi seksual

Aneksi 4 - Korniza për zhvillimin e një programi të përgjegjshëm ndaj gjinisë

Aneksi 5 - Udhëzues për prokurime publike të përgjegjshme ndaj gjinisë

Aneksi 6 - Lista e kontrollit për integrimin gjinor në nivel lokal

Aneksi 7 - Pyetësor për programin e buxhetimit të përgjegjshëm ndaj gjinisë

Aneksi 8 - Plan veprimi për barazinë gjinore në menaxhimin e mbetjeve

Aneksi 9 - Matrica për monitorimin e programeve lokale

Sweden
Sverige

SALAR International

Република Северна Македонија
Министерство за животна средина и просторно планирање

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Република Северна Македонија
Министерство за локална самоуправа

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

BNJVL